



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 01/2009
Më 20. 01. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Kaqusha Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Selvije Çeku dhe Izer Arifi (Zyra Ligjore në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë), Haxhi Gashi - nga USAID-i, Blerina Uka - nga NDI-ja, Kaltrina Ademi - nga KDI-ja.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22. 12. 2008,
3. Shqyrtimi i Projektraportit të Komisionit janar - dhjetor 2008,
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gazin natyror,
6. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22.12.2008;

Procesverbali i mbledhjes së 22 dhjetorit 2008 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektraportit të Komisionit janar - dhjetor 2008;

Kryetarja ua dha fjalën anëtarëve të Komisionit për komentimin e Raportit të Komisionit për punën e vitit 2008.

Sala Berisha – Shala – Tha se në parim pajtohet me këtë raport dhe propozoi të shtohet edhe konstatimi se Ligji për ngrohje qendrore i miratuar në Kuvend, por i pashpallur nga PSSP-ja, është hartuar me nismën e Komisionit të legjislaturës së dytë. Tha se raporti është gjithëpërfshirës dhe real, por pati vërejtje për funksionimin dhe për paraqitjen e punës së Komisionit para mediave, duke e përshkruar më tepër si reflektim dhe angazhim individual të kryetares. Shtoi se bartja e disa punëve të papërfunduara në këtë vit, siç janë dy projektligje dhe mospërfundimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për rrugët dhe mosrealizimi i asnjë vizite në vendet e rajonit ose më gjerë.

Berim Ramosaj – Vlerësoi se raporti njëvjeçar është përshkrim gjithëpërfshirës dhe konkret i punës së Komisionit dhe është i kënaqur me punën dhe me rezultatet e arritura të Komisionit gjatë vitit 2008. Tha se punën dhe udhëheqjen e Komisionit i ka karakterizuar fryma liberale e punës. Për këtë e falënderoi kryetaren për udhëheqje joautoritative, si dhe deputetët për kontributin e dhënë. Për suksesin e Komisionit tha se flasin edhe argumentet, amendamentimet e projektligjeve të votuara pa ma të voglën vërejtje në seancat e Kuvendit.

Ethem Çeku – E përkrahu Raportin e punës. Gjithashtu e përkrahu edhe idenë për t'i vizituar vendet që e kanë kaluar transicionin, si p.sh. Shqipëria, Maqedonia, Kroacia etj., përvojat e të cilave do të na shërbenin në punën tonë.

Kryetarja – Në diskutimin e saj tha se brenda Komisionit ka pasur transparencë të plotë, mirëpo në raste të caktuara ka munguar vetangazhimi i deputeteve, duke iu referuar vizitave në ndërmarrje publike, si dhe gjatë monitorimit të Ligjit për rrugët. Duke iu përgjigjur deputetes Sala Berisha – Shala, kryetarja tha se, edhe pse vjen nga opozita, ky fakt nuk është reflektuar asnjëherë, por gjithëherë punën tonë, në plan të parë, e ka përcjellë konstruktiviteti. Sa u përket vizitave jashtë vendit, mosrealizimin e tyre e arsyetoi me mungesë të buxhetit të Kuvendit. Në fund premtoi se gjatë vitit 2009 do të bëjë përpjekje që së paku të realizohen tri vizita jashtë vendit.

Pas një diskutimi të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti i punës së Komisionit janar – dhjetor për vitin 2008, me vërejtjet e Sala Berishës – Shala, lidhur me qartësimin e faktit që ka të bëjë me Ligjin për ngrohje qendrore.

IV. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave;

Kryetarja – Kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i japin komentet e tyre në parim lidhur më Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Pas diskutimit të gjerë nga deputetët: Ethem Çeku, Haki Shatri dhe Sala Berisha-Shala, Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet në parim Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave;
- II. Caktohet raportuese për këtë projektligj: Myzejene Selmani;

V. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gazin natyror

Kryetarja - Kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i japin komentet e tyre në parim, në lidhje me Projektligjin për gazin natyror.

Ethem Çeku – Kërkoi nga Komisioni që shqyrtimi në parim i këtij projektligji të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Sala Berisha – Shala – Po ashtu kërkoi sqarim nga z. Çeku për arsyet e tij për këtë propozim.

Ethem Çeku – Duke u përgjigjur tha se ky projektligj është i rëndësisë së veçantë dhe kërkon kohë dhe angazhim gjithëpërfshirës.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

- I. Shtyhet miratimi në parim i Projektligjit për gazin natyror për mbledhjen e radhës;
- II. Caktohet raportues për këtë projektligj: Ethem Çeku;

VI. Të ndryshme;

Në këtë pikë kryetarja parashtroi propozime që sipas saj duhet të trajtohen sa më parë që është e mundur, për shkak se tani është shtuar edhe volumi i punëve, si vijon:
P/ligji për zonat ekonomike dhe Projektligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- I. Haki Shatri caktohet raportues për Projektligjin për zonat ekonomike;
- II. Berim Ramosaj caktohet raportues për Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve;

VI. a) Monitorimi i Ligjit për rrugët nr. 2003/11

Kryetarja – Kërkoi nga grupi i punës, gjegjësisht nga raportuesi, Zef Morina, kryesues i këtij grupi, raportim për monitorimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11.

Zef Morina – Tha se së shpejti, para datës 15 shkurt 2009, do të mblidhet grupi i punës dhe do t'i raportojë Komisionit.

Ethem Çeku – Tha se nuk e preferon formën e vizitave në terren dhe kërkoi që së pari të ftohet Ministria që të raportojë për çështjen konkrete, të sjellë raportet, strategjitë etj. Pastaj, në qoftë se ka nevojë, të dilet në terren.

Zef Morina – Theksoi se pajtohet deri diku me z. Çeku, mirëpo atë që po e pohon z. Çeku, është e drejtë, por nuk është e domosdoshme, sepse roli i Kuvendit nuk është vetëm të nxjerrë ligje, por edhe t'i monitorojë. Kjo është punë e deputetit, respektivisht e komisioneve përkatëse.

VI.b) Çështjet vijuese

Kryetarja – Propozoi që në mbledhjen e ardhshme të vihen në rend dite shqyrtimi në parim i projektligjeve, siç janë: për gazin natyror, për zonat ekonomike dhe për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve nr. 2004/17.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani